## Kompensimi i kostos së energjisë

Mbasë një postulat të Alternative Liste (AL), për vitin 2024, amvisnit me të ardhura të ulëta në qytetin e Cyrihut do të marrin një subvencion për koston e energjisë, që të mund të paguajnë faturat shumë të larta të shpenzimeve shtesë.

Të drejtën për këtë kompensim e kanë amvisnit, të cilat me 2023 kanë përfituar nga reduktimi i premive të sigurimit shëndetësor.

Në muajin maj Enti për Përfitime Shtesë (Amt für Zusatzleistungen) do të dërgojë formularin e aplikimit. Luteni që këtë formular gjithsesi ta plotësoni në letër apo online dhe deri më 30 shtator ta dërgoni prapa!

Ia vlen: Varësisht nga madhësia e amvisnisë përfitohen 200 deri 1100 franga:

| Lloji i amvisnisë | Kompensimi i kostos së energjisë në franga | | |
|---|---|---|---|
| | Ngrohje me gaz | Ngrohje me naftë | Ngrohje me dru |
| Amvisni me 1 person | 430 | 334 | 198 |
| Amvisni me 2 persona | 602 | 470 | 277 |
| Amvisni me 3 persona | 774 | 606 | 357 |
| Amvisni me 4 persona | 946 | 742 | 435 |
| Amvisni me 5 persona | 1118 | 878 | 515 |

https://www.stadt-zuerich.ch/energiekostenzulage